



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, më 9 mars 2018, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-1-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Avdullah Hoti, Andin Hoti, Muharrem Nitaj, Albert Kinolli dhe Ali Lajçi.

Munguan: Verica Çeraniq, Faton Topalli, Zafir Berisha dhe Shqipe Pantina.

Stafi mbështetës i komisionit: Mehmet Simnica.

Pjesëmarrësit tjerë: Marjan Dema, Myrvete Badivuku-Pantina, Esat Kelmendi, Ilir Hajdaraj nga UP-ja; Bujar Bajraktari, Valbon Bytyçi, Florim Beqiri nga ZKA-ja dhe Mentor Hyseni nga GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 28.2.2018;
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;
4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Universitetit të Prishtinës (UP), për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;
5. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.2.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 28.2.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

Kryetari njoftoi deputetët se ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Shyqiri Bytyçi, për shkak të agjendës, nuk do të jetë prezent në këtë takim, andaj pa prezencën e ministrit, nuk mund ta shqyrtojë raportin.

Përfundim

KMFP vendosi që shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të bëhet në mbledhjen e radhës të komisionit.

4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Universitetit të Prishtinës (UP) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

Kryetari njoftoi se deputeti raportues për UP-në, është Andin Hoti dhe sqaroi se ne kemi ndarë këto raportime në këto tematika. Më tej, kryetari ftoi përfaqësuesit e Zyrës së Auditimit të prezantojnë të gjeturat e raportit për UP-në.

Valbon Bytyçi, paraqiti në pika të shkurtra opinionin e dhënë të auditimit për UP-në, për vitin 2016, si dhe përmendi disa të gjetura kyçe.

Andin Hoti, theksoi se objektivi i auditimit ishte: Pasqyrat financiare vjetore, qeverisjen, menaxhimin financiar dhe kontrollin. Opinioni i auditorit të përgjithshëm është opinion i pamodifikuar, me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes është dhënë në faktin se informatat e shpalosura në PFV, në lidhje me pasuritë dhe stoqet, nuk janë të sakta. Përveç kësaj, shpenzimet në vlerë prej 296,614€ ishin keq-klasifikuar. Të gjeturat kryesore: shpenzimet në vlerë prej 296,614€, ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht në kategoritë joadekuate. Po ashtu, 2 (dy) pagesa, në vlerë të përbashkët 229,244€, të cilat sipas natyrës iu përkasin mallrave dhe shërbimeve, ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht nga investimet kapitale. Ndërsa, 2 (dy) pagesa tjera, me vlerë të përbashkët 67,370€, të cilat i përkasin investimeve kapitale, ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht nga mallrat dhe shërbimet, po ashtu shpalosjet e pasurive fikse nuk janë plotësisht të sakta dhe të besueshme. Regjistri i pasurive kapitale nuk ka përfshirë të gjitha pronat që janë në shfrytëzim dhe në pronësi të UP-së, për shkak të problemeve të pazgjithura pronësore. Më tutje, regjistri i pasurive me vlerë nën 1,000€, ishte i mbivlerësuar për 408,518€, ngase nuk ishte kalkuluar zhvlerësimi i pasurisë nga 3 (tri) njësi akademike. Përveç kësaj, ne kemi identifikuar pasuri në vlerë prej 25,873€, të cilat nuk janë evidentuar në regjistrat e pasurive nga njësitë akademike. Ndërsa, sa i përket stoqeve, në PFV ishin deklaruar

vetëm stoqet që ishin në Rektorat, në vlerë 22,000€, duke mos përfshirë stoqet e njësive akademike. Te qeverisja, të gjeturat kryesore: Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak, rekomandime të zbatuara, 10 janë në proces të zbatimit dhe 5 rekomandime nuk janë zbatuar. Mangësi në procesin e raportimit dhe kontrollet menaxheriale. Pyetësi i vetëvlerësimit dhe funksionimi dhe efikasiteti i NJAB-së. Menaxhimi financiar dhe kontrolli, të gjeturat kryesore: menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkojnë procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës, të cilët e sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve, rregulloreve dhe proceseve të tjera të kontrollit; kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve, përfshirë pagat dhe shpenzimet, përmes prokurimit, kanë nevojë për përmirësim. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit. Angazhimi i profesorëve në kundërshtim me rregulloren; mungesë e dëshmive për orët e mbajtura nga profesorët; kompensimet e mësimdhënësve për provimet; kompensimet e komisioneve të themeluara brenda UP-së; verifikimi i listave të mbajtjes së procesit mësimor; kompensimi i profesorëve pa kontratë. Tek investimet kapitale, shpërblimi me kontratë i ofertuesit që nuk i plotëson kriteret; shmangie nga kërkesat për menaxhimin e kontratave; planifikim jo i mirë i prokurimit; mangësi në përdorimin e sistemit e-pasuria; menaxhimi i obligimeve të papaguara. Rekomandim i hartuesit të përmbledhjes: rektori i UP-së duhet të sigurojë që të përgatitet dhe të zbatohet plani i veprimit dhe duhet të sigurojë zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm, nga viti paraprak dhe ai aktual. Një raport me të arriturat e zbatimit të rekomandimeve duhet t'i dërgohet Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, jo më larg se 2 muaj.

Rektori i UP-së duhet të sigurohet që vendimet e Senatit për angazhimin e stafit akademik të jenë në harmoni me dispozitat e aplikueshme të rregulloreve përkatëse dhe duhet të sigurojë që të përmirësohen kontrollet e monitorimit të vijueshmërisë së procesit mësimor.

Raporti i hartuar, me përmbledhje të rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm për UP-në, nuk ka nevojë për procedim në Kuvend, por rektori duhet të sigurojë që këto rekomandime do të zbatohen në një afat kohor prej 2 muajve.

Marjan Dema, theksoi bashkëpunimin e ngushtë me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe me Zyrën Kombëtare të Auditimit, jemi shumë të interesuar për transparencë që të gjitha dobësitë t'i përmirësojmë. Po ashtu, pajtohemi me këto të gjetura dhe me këto rekomandime. Qëllimi ynë do të jetë zero tolerancë ndaj shkelësive të ligjit. Që mos të kemi të gjetura dhe jemi të vëmendshëm që kjo nuk arrihet brenda ditës, jemi në proces që t'i eliminojmë këto. Mendoj që në raportet tjera të auditimit, të kemi një progres shumë të madh, sa i përket respektimit të rekomandimeve, po prapë po theksoj se derisa të arrijmë të ketë zero të gjetura dhe zero rekomandime, nuk jemi duke kryer punën tonë si duhet. Pastaj kemi trashëguar një staf joprofesional në administratë dhe është mungesë e stafit. Jemi të vetëdijshëm për një menaxhim të mirëfilltë për një kontroll të mirëfilltë, për shumë raporte që duhet hapur. Nëse kemi parasysh se kemi 300 deri 320 punonjës të administratës, me 50,000 studentë, mbi 2,000 të punësuar, kemi bërë ndryshime te pagesat e provimeve, temave, kemi kursyer mbi 1 milion, më nuk paguhen profesorët për provime dhe tema, kemi plotësuar krejt infrastrukturën tonë me rregullore të menaxhimit, që të mos bëhet asnjë pagesë pa kalkuluar nëpër trupat e pavarur.

Muharrem Nitaj, tha se z. rektor, ju deklaruat më herët se i keni ndaluar pagesat shtesë për provimet dhe për temat e diplomave, ka qenë një formë e kapërcimit enorm të pagave, që kanë marrë mësimdhënësit e UP-së. A është absolut ky vendim dhe a keni ndërprerë pagesat për provime dhe tema të diplomës, për të gjitha njësit akademike apo është selektive? Sa keni arritur të vendosni një kontroll, që disa prej njerëzve të fuqishëm në UP, të mos paguhen me paga enorme në emër të shërbimeve dhe punës akademike që e kryejnë?

Marjan Dema, tha se shqetësimet janë me vend. Sa i përket pjesës së parë, përgjigjja është absolute, sepse nuk guxon të ndodhë në mënyrë selektive. Sa i përket pjesës së dytë, prej ardhjes së këtij menaxhmenti, janë krijuar standarde dhe ato standarde janë respektua 100%. Pra, e them me përgjithësi se nuk ka mundësi të kalojë dikush, pa i plotësuar standardet, sepse jemi shumë transparentë dhe kemi plotësuar rregulloret për gjithçka. Aty ku nuk kemi rregullore, kam marrë vendim personal mbi bazën e ligjit, se nuk guxon asnjë profesor të marrë pagë mbi 150% d.m.th. 100% e kanë pagën në një gjë të precizuar me 50% neto, realizon sa do, mbi këtë nuk guxon të paguhet, për këtë gjë i kam dhënë urdhër drejtorit, nëse ky nuk e realizon, duhet të japë përgjithësi, kemi krijuar pakënaqësi, sepse kemi bërë pakë reforma, por më shumë sesa kemi mundur të përballojmë.

Albert Kinolli, tha se ne kemi përgjegjësi institucionale dhe përgjegjësi ndaj shpenzimeve të parasë publike. Sa i përket këyre dy shumave që u përmenden nga auditori po edhe nga kolegu im i nderuar, Andin Hoti, ku janë ngatërruar pagesat apo kodet, sa i përket investimeve kapitale dhe shërbimeve, unë nuk dëgjova një përgjigje konkrete nga ju, z. rektor. Po ashtu, nga shumica e rekomandimeve të vitit 2016, ju keni zbatuar vetëm disa rekomandime, disa janë duke u zbatuar dhe 5 prej tyre nuk janë zbatuar fare. Cila është arsyeja për këto 5 rekomandime, të cilat nuk janë zbatuar fare?

Iir Hajdaraj, tha se sa i përket pyetjes lidhur me keq-klasifikimin e shpenzimeve në dy kategori, prej mallrave dhe shërbimeve në investime kapitale dhe prej investimeve kapitale në mallra e shërbime, problemi qëndron këtu: ne kemi buxhetuar në projektet kapitale një shumë të buxhetit që ka qenë 3 milionë në vitin 2016, në vlerën 229,244 ero, janë blerë pajisjet e teknologjisë informative, pjesa tjetër 67,370 ero, janë bërë renovimet në objekte, në mënyrë emergjente. Universiteti ka probleme me planin kontabël të thesarit, sepse është shumë specifik. Specifikat e Universiteti nuk i plotëson plani kontabël dhe aty kemi shumë probleme me përshtatjen e kodeve ekonomike të shpenzimeve.

Muharrem Nitaj, pyeti: Kush ka vendosur të kalojë 10%-shin e famshëm që është i lejuar, a është vendim i Këshillit Drejtues, vendim i drejtorit apo e keni bërë ju? Meqenëse është shkelje.

Iir Hajdaraj, buxheti i Universitetit miratohet në Këshillin Drejtues dhe ky buxhet është miratuar nga Këshilli Drejtues. Këto shpenzime janë miratuar nga Këshilli Drejtues, për nevoja që kanë qenë urgjente.

Myrvete Badivuku-Pantina, është theksuar në raporte, se disa rekomandime nuk janë adresuar dhe ato që faktikisht nuk kemi arritur t'i adresojmë në 2016, kemi vazhduar në vitin 2017, të punojmë në drejtim të zbatimit të atyre rekomandimeve, meqenëse ato janë përsëritur, mirëpo mbetëm ende pa u implementuar. Rekomandimi që ka të bëjë me pasuritë financiare me vlerë mbi 1,000 euro, në fakt këto janë pasuritë e UP-së. Një problem që na paraqitet në UP, është detyrimi kontingjent, meqenëse Universiteti ka lëndë në gjykata dhe ne nuk mund të parashohim saktësisht sa lëndë do t'i kemi brenda një periudhe të caktuar kohore, prandaj edhe parashikimi i këtyre shpenzimeve nuk është i saktë.

Esat Kelmendi, desha të plotësoj detyrimet kontingjentit, arsyet mos implementimin e përgjithshëm të këtij rekomandimi është se kemi një borxh rreth 470 mijë euro për profesorët që në vitin 2015 janë larguar apo ju është ndryshuar kontrata nga ish-rektori dhe të cilët

inspektoriati dhe gjykata javë ka njohur si të drejt të tyre, dhe kemi borxhe, keni paraqitur kërkesën në Qeveri për na mbush ato mjete në mënyrë që ti realizojmë ato pagesa e tyre, deri me tani nuk kemi përgjigje ende ndërkohë kemi arritur marrëveshje me gjykatë të paguhet në menyrë sistematike gjatë vitit 2018, ne faktikisht ende nuk kemi filluar me pagesa, pastaj kemi vendime për të cilat nuk mund parashohemi apo nuk kemi i informata nga gjykata sa lëndë i kemi në proces në gjykata apo si mund të jetë rezultati final i atyre akt-gjykimeve, prandaj kjo fushë mbetet sfidë edhe për të ardhmen, për derisa në UP shpallet konkurs për 50 vende pune për profesor aplikojnë 4 fishi i tyre dhe të gjithë këta të tjerët që nuk pranohen parashtrajnë ankesa, nga njëherë edhe pa të drejt gjykata ua njeh të drejtën e kompensimit dhe fatkësishtë dëmton buxhetin e Universitetit të Prishtinës.

Kryetari njoftoi deputetët se KMFP ka përgatitur disa rekomandime për UP-në, te cilat janë: Rektori i UP-së duhet të sigurojë që të përgatitet dhe të zbatohet plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm. Një raport me të arriturat e zbatimit të rekomandimeve duhet t'i dërgohet Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, brenda 2 (dy) muajve. Në veçanti, për këto të gjetura, rektori i UP-së duhet të sigurohet që vendimet e Senatit për angazhimin e stafit akademik të jenë në harmoni me dispozitat e aplikueshme të rregulloreve përkatëse dhe duhet të sigurojë që të përmirësohen kontrollet e monitorimit të vijueshmërisë së procesit mësimor. Rektori i UP-së duhet të sigurohet se informatat rreth stoqeve të njësisve akademike të jenë shpalosur në PFV-të dhe këto stoqe të inventarizohen dhe vlerësohen sipas rregulloreve në fuqi. Planifikimi i prokurimit të përgatitet dhe të konsolidohet, paraprakisht për të gjitha kërkesat individuale të fakulteteve. Po ashtu, mënjanimi i mangësive në menaxhimin e kontratave, si dhe përgatitja e planeve për menaxhimin kontratave.

Përfundim

KMFP vendosi që raporti i auditimit për PVF-të e UP-së për vitin 2016, të mos adresohet për në seancë plenare, megjithatë rekomandimet t'i drejtohen Menaxhmentit të UP-së.

5. Të ndryshme

Kryetari njoftoi deputetët se në mbledhjen e kaluar është vendosur që projektligji për kontabilitet dhe raportim financiar, të mos shqyrtohet në KMFP, për shkak se është jashtë fushëveprimit të KMFP-së. Megjithatë, pas bisedave që kemi pasur me drejtorin për Mbështetje të Komisioneve Parlamentare, është vendosur që ky projektligj të kalojë në lexim të parë në KMFP dhe më pastaj të ngarkohet KBF për shqyrtim të mëtejshëm. Administrata ka përgatitur formën standarde si vijon: Të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim. Kryesia e Kuvendit, pas miratimit në lexim të parë të Projektligjit nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, ta ngarkojë për shqyrtim të mëtejshëm Komisionin për Buxhet dhe Financa, si Komision funksional.

Përfundim

KMFP vendosi, njëzëri, që Projektligjin nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, ta miratojë në parim.

Kryetari njoftoi deputetët për listën e raporteve që do të shqyrtohen në KMFP, deri në fund të muajit prill 2018 dhe për mbledhjen e radhës se KMFP-së, prapë do të vazhdohet sipas orarit të

shqyrtimit të raporteve. Për këtë do t'ju njoftojë administrata e KMFP-së, para takimit të radhës. Me këtë, takimi përfundoi.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj